



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

KANDIDATËT QË PLOTËSOJNË KRITERET PARAPRAKE PËR THIRRJEN:

SHPLLJE NJOFTIMI PËR 1 (NJË) VEND TË LIRË PUNE NË QENDRËN E OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE KURBIN

Komisioni për zhvillimin e procesit të konkurimit për 1 (një) vend të lirë pune në Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kurbin, ngritur me urdhër nr. 433 datë 25.09.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, u mbledh më datë 27.09.2023, me qëllim shqyrtimin e aplikimeve, sa i përket përmbushjes së kërkesave të posaçme dhe dokumentacionit sipas thirrjes së publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas si dhe në bazë të Urdhrit nr. 53 datë 26.05.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas «*Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të kandidatëve për punonjës pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore*».

Nga verifikimi në protokoll, rezulton se për vendin vakant pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kurbin kanë shprehur interes **2 (dy) aplikantë** si vijon:

1. **Zj. Eneida Gjonaj** (kërkesa me nr. 1815 prot datë 21.09.2023, me anë të shërbimit postar);
2. **Z. Ernest Bunaj** (kërkesa me nr. 1819 prot., datë 22.09.2023, me anë të shërbimit postar);

Pas shqyrtimit të dosjeve personale të aplikantëve, sipas metodologjisë së vlerësimit, Aneks-it 1 të miratuar me urdhërin nr. 53, datë 26.05.2021 “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të kandidatëve për punonjës pranë qendrave të shërbimit të ndihmës parësore”, komisioni vendosi që aplikantët të cilët plotësojnë kriteret për të vazhduar procesin e konkurimit janë:

1. **Zj. Eneida Gjonaj**
2. **Z. Ernest Bunaj**

Aplikantët e kualifikuar për shpalljen duhet të paraqiten pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për t’u nënshtruar provimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

❖ **Provimi me shkrim** do të zhvillohet më datë **28.09.2023, ora 11:00**, pranë ambienteve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Provimi me shkrim do të zhvillohet mbi:

- Njohuri të thelluara mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, Ligjin nr.111/2017, kushtet dhe kërkesat e ligjit për të përfituar nga shërbimet e ndihmës juridike falas;

- Njohuri të plota teorike dhe praktike mbi legjislacionin dhe të drejtën civile, penale dhe administrative.
- ❖ **Intervista e strukturuar me gojë** do të zhvillohet më datë **28.09.2023, ora 12:30**, pranë ambienteve të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet mbi:

- Njohuritë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e punës, eksperiencën e mëparshme, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Mos paraqitja e kandidatëve në datën e orën e caktuar passjell skualifikimin.

Adresa: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Rruga “*Jordan Misja*”, Njësia Bashkiake nr. 9,
Godina nr.3, Tiranë

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ergys Qirici